REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

Nr 9242/1 Prot. Lushnje, më 20/10/2025

PROJEKT - VENDIM

NR. 92 DATË 20/10/2025

PËR " PËRFUNDIMIN E PROÇEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS , DREJTORIA VENDORE LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2025 në mbështetje të: Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, VKM Nr.97, datë 3.2.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", VKM Nr. 179, Datë 26.2.2020 "Për rregullat, kushtet dhe proçedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit Nr. 7652, Datë 23.12.1992, "Për Privatizimin e Banesave Shtetërore", dhe të Ligjit Nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për Privatizimin e Banesave dhe Objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e Shoqërive dhe të Ndërmarrjeve Shtetërore " pika 5, pika 27 dhe 37, nenet 1 dhe 2 të Dekretit të Presidentit nr. 1440 datë 04.04.1996 "Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara" , neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë , paragrafi II "… regjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykatë apo të një organi tjetër shtetëror kompetent , si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj …" si edhe nenit 193/b të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, **JU**

PROPOZOJMË :

I.Të përfundojë procedurat e privatizimit të apartamentit dhe të lidhet kontrata e shitblerjes para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë ASHK–së,Drejtoria Vendore Lushnje, *sipas dokumentacionit përkatës të privatizimit të ndodhur në dosjet për qytetarin*

Z.Hyqmet Korreshi, vendndodhja e apartamentit: *lagjia "Gafurr Muço", Njësia Administrative Nr.4, Bashkia Lushnje* , pallati PF-1 , kati 5 ,shkalla 2, e përbërë nga 1+1 (dhoma + kuzhinë) ,sipërfaqe 57.0 m2 (sipas planimetrisë dhe plan rilevim bashkangjitur).

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnje ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORI JURIDIK
Bedri HIDA

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE- BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

Nr 9242 prot Lushnje ,më 20/10/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

PËR " PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS , DREJTORIA VENDORE LUSHNJE"

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Pranë Institucionit të Bashkisë Lushnje,është paraqitur 1(një) kërkesë nga **Z.Hyqmet Korreshi**,për të përfunduar procedurën e privatizimit të banesës.

Ju bëjmë me dije se, referuar VKM Nr.97, datë 3.2.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", VKM Nr. 179, Datë 26.2.2020 "Për rregullat, kushtet dhe proçedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit Nr. 7652, Datë 23.12.1992, "Për Privatizimin e Banesave Shtetërore", dhe të Ligjit Nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për Privatizimin e Banesave dhe Objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e Shoqërive dhe të Ndërmarrjeve Shtetërore :

Ky aplikues ka paraqitur dokumentacion të plotë: çertifikatë 01.12.1992, mandat arkëtimet që kanë shlyer të gjithë vlerën monetare të banesave të tyre sipas tarifave të përcaktuara në legjislacion, formularin nr.2 në të cilën tregohen elementet e përllogaritjes së vlerës,kategoria,vendosja etj, të banesës dhe përfituesve të tij, formulari nr.3 kontrata tip me ish-Ndërmarrjen Komunale të banesave, planimetri, planvendosje dhe planrilevim.

Këtë atribut aktualisht, për miratimin e procedurës së privatizimit e kanë Këshillat Bashkiak , ndërsa për lidhjen e kontratës së shitblerjes e ka Institucioni Bashkia Lushnje.

Faleminderit për mirëkuptimin !

Konc:J.Sulo

DREJTORI JURIDIK

Bedri Hida

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com